Nr.11243-01441-00-2013 i Regj. Themeltar
Nr.00-2013-1735 i Vendimit (356)

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Majlinda Andrea	Kryesuese
Guxim Zenelaj	Anëtar
Mirela Fana	Anëtare
Admir Thanza	Anëtar
Artan Broci	Anëtar

në datën 06.06.2013 mori në shqyrtim në seancën gjyqësore çështjen civile nr.11243-01441-2013 Regj.Themeltar, që i përket palëve:

PADITËS:	SHOQËRIA "MARKO TEL & HES KABLO ALBANIA" Shoqëri e thjeshtë, përfaqësuar nga av. Genci Çifligu.
I PADITUR :	SHOQËRIA "ZTE ALBANIA" SH.P.K., përfaqësuar nga av. Vangjel Kosta dhe av. Entela Memishaj.
PERSON I TRETË:	ALBTELKOM SH.A., në mungesë.

OBJEKTI I PADISË:
Detyrimin e të paditurit të paguajë në favor të paditësit
shumën prej 24 742.12 Euro, shumë kjo e përllogaritur
deri me datë 30.04.2012, si shumë që rrjedh nga likuidimi me vonesë
i faturave që rrjedhin nga punimet e kryera
sipas kontratës së datës 18.04.2011.
Baza Ligjore: Nenet 32 dhe 153 e vijues të K.Pr.Civile,
nenet 850 e vijues, nenet 690, 693,
nenet 419, 420, 445, 448, 450, 463, 476, 481 të K.Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim nr.1460, datë 18.02.2013, ka vendosur:
Nxjerrjen e çështjes civile nr.3292 akti, datë regjistrimi 30.05.2012 jashtë juridiksionit gjyqësor.

Kundër vendimit nr.1460, datë 18.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur ankim të veçantë pala paditëse, Shoqëria "Marko Tel & Hes Kablo Albania", me anë të të cilit kërkon prishjen e vendimit nr.1460, datë 18.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për gjykim pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues, për këto shkaqe:

- Palët në gjykim, paditësi Shoqëria "Marko Tel & Hes Kablo Albania" shoqëri e thjeshtë dhe pala e paditur, Shoqëria " ZTE Albania" sh.p.k janë persona juridikë të regjistruar sipas ligjeve në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë, në këto kushte parashikimet e Nenit 400 e vijues të K.Pr.Civile për gjykimin në arbitrazh janë të vlefshme dhe aplikohen vetëm në ato raste kur palët kanë zgjedhur me marrëveshje

gjykimin e mosmarrëveshjeve të tyre në arbitrazh dhe në ato raste kur arbitrazhi zbatohet sipas parimit të K.Pr.Civile. Në rastin konkret ndodhemi përpara dy personave juridikë shqiptarë, pasi të dy janë themeluar sipas të drejtës shqiptare dhe kanë selinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Kushti i parë për të pasur gjykim arbitrazhi ndërkombëtar sipas marrëveshjeve të palëve kërkon si kusht të parë atë të qenies së një personi në marrëveshje subjekt i një shteti tjetër. Kjo në zbatim të Nenit 2 të Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit".
- Kjo dispozitë e interpretuar në lidhje me nenet 400 dhe 472 të K.Pr.Civile përcakton se dallimi ndërmjet arbitrazhit të brendshëm dhe atij të huaj qëndron në faktin se ku ndodhet vendi i procedurës, nëse ajo ndodhet në shtetin shqiptar apo jashtë tij.
- Gjithashtu neni 1 i Konventës Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar të Gjenevës datë 21.04.1961, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin 8687, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit", parashikon se për të pasur arbitrazh ndërkombëtar kushti i parë ka të bëjë më natyrën e subjekteve dhe konsiston në faktin se ato duhet t'i kenë selitë e tyre në dy vende të ndryshme, dhe kushti i dytë ka të bëjë me atë që mosmarrëveshjet që duhet të zgjidhen nga një arbitrazh ndërkombëtar kanë të bëjnë me marrëdhënie ndërkombëtare.
- Parimi i përcaktuar në dy konventat e sipërcituara është se palët mund t'i drejtohen një arbitrazhi ndërkombëtar në rastin kur ato janë persona juridikë të dy vendeve të ndryshëm.
- Nuk qëndron fakti i pretenduar në gjykim se në këto raste ndodhemi përpara një rregullimi ligjor të bërë me marrëveshje ndërkombëtare, të cilat kanë prioritet mbi ligjin vendas.
- Nuk ndodhemi përpara rastit kur juridiksioni i gjykatave shqiptare të jetë përjashtuar nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare, pasi marrëveshja ndërkombëtare e cituar nga pala e paditur në kërkesën e saj nuk përfshin si subjekte mbi të cilat ajo të shtrijë efektet, rastet kur palët në një gjykim janë persona juridikë të një shteti anëtar i kësaj konvente. Kjo në frymë e nenit 37/2 të K.Pr.Civile.

Kundër rekursit të paraqitur nga pala paditëse, ka paraqitur kundër-rekurs pala e paditur "Shoqërisë ZTE Albania" shpk, me anë të të cilit kërkon mospranimin e rekursit dhe lënien në fuqi të vendimit nr.1460, datë 18.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për këto shkaqe:

- Rekursi është i paqartë. Në rekurs referohen dhe analizohen dispozita ligjore të cilat nuk kanë lidhje me vendimin e gjykatës për deklarimin e mungesës së juridiksionit gjyqësor. Referohen dhe analizohen nenet 400 e vijues të K.Pr.Civile që lidhen me arbitrazhin vendas, ndërkohë që jemi përpara një "arbitrazhi ndërkombëtar".
- Në rekurs analizohen në mënyrë të pasaktë aktet ndërkombëtare të lidhura me arbitrazhin ,qoftë Konventa "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", qoftë Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar të Gjenevës datë 21.04.1961.

- Në rekurs nuk ngrihet asnjë pretendim mbi "nulitetin apo pamundësinë e zbatimit të klauzolës së arbitrazhit" por vetëm pretendohen se akti i mësipërm kushtëzon arbitrazhin me "qenien e palëve në mosmarrëveshje nga vende të ndryshme". Neni 2 i Konventës së New York nuk lidhet me pasjen e subjekteve të selive në shtete të ndryshme, por me njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi në një vend të ndryshëm nga vendi në të cilin është zhvilluar procedura e arbitrazhit.
- Referimi në nenin 37/2 të K.Pr.Civile nuk ka asnjë lidhje me pretendimin në rekurs. Nga përmbajtja e kësaj dispozite është e qartë se qëllimi i saj është të rregullojë marrëdhëniet juridiksionale ndërkombëtare, pra marrëdhëniet ndërmjet juridiksionit të gjykatave shqiptare dhe gjykatave të huaja për subjekte "jo shqiptare".

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtares Mirela Fana; përfaqësuesin e palës paditëse Av. Genci Çifligu, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues; dëgjoi përfaqësuesit e palës së paditur Av. Vangjel Kosta dhe Av. Entela Memishaj, të cilët kërkuan lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; si diskutoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Rrethanat e faktit

Paditësi, Shoqëria "Marko Tel & Hes Kablo Albania", shoqëri e thjeshtë dhe i padituri, Shoqëria "ZTE Albania" shpk, janë persona juridikë shqiptarë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ndërmjet Shoqërisë "Marko Tel & Hes Kablo Albania" shoqëri e thjeshtë dhe personit të tretë, Shoqëria "Albtelekom" sh.a, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr.371 Rep., 207 Kol., datë 16.01.2008, me objekt realizimin e punimeve për rrjetin kabllor të Shoqërisë Albtelecom Shqipëri, me vlerë të përgjithshme të punimeve 20.000.000 LTR.

Në datën 18.04.2011, palët pjesëmarrëse në Kontratën nr.371 Rep., 207 Kol., të datës 16.01.2008, e kanë amenduar atë (Kontratën) me amendamentin nr.2, ku është përfshirë si palë edhe i padituri, Shoqëria "Z.T.E Albania" shpk.

Palët në këtë amendament me vullnetin e tyre kanë ndryshuar gjithashtu edhe nenin 44 "Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve" të kësaj kontrate, në të cilin është parashikuar se:

"*Kjo Kontratë Sipërmarrje do udhëhiqet nga ligjet e Anglisë dhe Uellsit, duke përjashtuar konfliktin ndërmjet ligjeve të aplikueshme. Çdo ndryshim ose mosmarrëveshje që do mund të lindë nga ose në lidhje me këtë Kontratë Sipërmarrje do të zgjidhet me marrëveshje miqësore nga ana e palëve. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen brenda dyzet e pesë ditëve pas dërgimit të njoftimit me shkrim nga njëra palë, e cila kërkon zgjidhjen, secila palë mundet që ta paraqesë mosmarrëveshje në arbitrazhin e Gjykatës së Londrës për Rregulloren Ndërkombëtare të Arbitrazhit. Vendi i arbitrazhit është Anglia*".

Pala paditëse, Shoqëria "Marko Tel & Hes Kablo Albania" shoqëri e thjeshtë, me pretendimin se pala e paditur, Shoqëria "ZTE Albania" shpk, ka kundrejt saj detyrimin prej 24.742.12 Euro, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë padinë me objekt detyrimin e palës së paditur për kthimin e kësaj shume.

Paditësi pretendon se shuma prej 24.742.12 Euro përfaqëson shumën që rrjedh nga likuidimi me vonesë i faturave nga punimet e kryera sipas kontratës së datës 18.04.2011, të përllogaritura deri më datë 30.04.2012.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në seancën e datës 06.02.2013, përfaqësuesi i palës së paditur "Shoqërisë ZTE Albania" shpk parashtroi kërkesën paraprake me objekt nxjerrjen e

çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi palët në nenin 44 të amenduar të kontratës së sipërmarrjes nr.371 Rep., 207 Kol., datë 16.01.2008, "Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve", kanë përcaktuar se ligji i zbatueshëm është legjislacioni i Anglisë dhe Wales (Uellsit) dhe të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me procedurë arbitrazhi sipas rregullave të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Londrës dhe vendi i arbitrazhit do të jetë Londra.

Pala e paditur pretendon se kjo klauzolë e kontratës është në përputhje me nenin 2 të Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York më datë 10.06.1958, konventë në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit".

Pala paditësi Shoqëria "Marko Tel&Hes Kablo Albania" prapëson pretendimin e palës së paditur duke parashtruar se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me argumentin se klauzola e arbitrazhit e parashikuar në nenin 44 të Kontratës së amenduar nuk duhet zbatuar në rastin në shqyrtim. Kjo palë vazhdon argumentin se palët ndërgjyqëse janë subjekte të së drejtës shqiptare, për rrjedhim në këtë rast nuk ka vend për aplikimin e së drejtës ndërkombëtare.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr.1460, datë 18.02.2013, ka vendosur nxjerrjen e kësaj çështjeje civile jashtë juridiksionit gjyqësor.

Gjykata arsyeton se: *".....kjo klauzolë është në përputhje me përcaktimin e Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958, konventë në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit". Në nenin 2 të kësaj konvente.... në rastin objekt shqyrtimi gjyqësor klauzola e përcaktuar në nenin 44, të amenduar të kontratës së sipërmarrjes nr.371 Rep.., 207 Kol., datë 16.01.2008 është e vlefshme, sepse referimi i zgjidhjes së çështjes në arbitrazhin ndërkombëtar është pranuar nga palët të cilat kanë firmosur kontratën përkatëse. Nga përmbajtja e nenit 2 të Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958, rezulton se palët në një marrëdhënie juridike kontraktore janë të lira që të zgjedhin që çështja e tyre të shqyrtohet nga një arbitrazh ndërkombëtar. Në rastin në gjykim palët kanë zgjedhur që mosmarrëveshjet e tyre të gjykohen në një procedurë arbitrazhi ndërkombëtar në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Londrës. Palët kanë përcaktuar edhe vendin e zhvillimit të arbitrazhit, që do të jetë Anglia. Dhe që ligji i aplikueshëm është ligji i Wales dhe i Anglisë, ligj ky i cili zbatohet në vendin e zhvillimit të arbitrazhit. Në këtë kontekst gjykata çmon se klauzola e arbitrazhit e përcaktuar nga palët ndërgjyqëse është e vlefshme.... Referimi i çështjes në një arbitrazh ndërkombëtar nuk vjen në kundërshtim me nenin 37/2 të K.Pr.Civile, për sa kohë që Konventa "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York më datë 10.06.1958, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit" përbën burim legjislativ të detyrueshëm për zbatim në Republikën e Shqipërisë, pas aderimit në të me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000....Fakti që një arbitrazh konsiderohet si ndërkombëtar, vetëm nisur nga fakti që ai ndodhet në një vend të ndryshëm nga ai ku palët kanë qendrat e tyre të biznesit, ose ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtare, është përcaktuar shprehimisht në Notën Shpjeguese të Sekretariatit të UNCITRAL mbi Ligjin Model të Një Arbitrazhi Ndërkombëtar .....gjithashtu që referimi i personave të të njëjtit shtet në një arbitrazh ndërkombëtar nuk pengohet as nga Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar të Gjenevës datë 21.04.1961 në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin 8687, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit"... palët e një mosmarrëveshje pavarësisht faktit që mund të jenë persona*

juridikë ose fizikë nga i njëjti shtet, mund ta referojnë çështjen e tyre në një arbitrazh ndërkombëtar në bazë të Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958, pavarësisht përcaktimeve të Konventës Europiane Mbi arbitrazhin Ndërkombëtar të Gjenevës, datë 21.04.1961….."

Pala paditëse, Shoqëria "Marko Tel & Hes Kablo Albania", duke mos qenë dakord me vendimin nr.1460, datë 18.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur ankim të veçantë, me anë të të cilit kërkon prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për gjykim pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues për shkaqet e paraqitura në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Kundër ankimit të paraqitur nga pala paditëse, Shoqëria "Marko Tel & Hes Kablo Albania", ka paraqitur kundër-rekurs pala e paditur "Shoqërisë ZTE Albania" shpk me anë të të cilit kërkon mospranimin e rekursit dhe lënien në fuqi të vendimit nr.1460, datë 18.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkaqet e parashtruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se vendimi nr.1460, datë 18.02.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe si i tillë ai duhet të lihet në fuqi.

Ky Kolegj vlerëson se ankimi i veçantë i paraqitur nga paditëse Shoqëria "Marko Tel & Hes Kablo Albania" nuk përmban shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të K.Pr.Civile, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Kolegj çmon se çështja e juridiksionit është një nga çështjet më të rëndësishme procedurale, mosrespektimi dhe moszgjidhja drejt e së cilës sjell automatikisht prishjen e vendimit. Përcaktimi i saktë i juridiksionit, pra nëse çështja hyn në juridiksionin gjyqësor apo në ndonjë juridiksion tjetër (siç është pretendimi në rastin konkret që mosmarrëveshja duhet t'i nënshtrohet procedurës së arbitrazhit), ka rëndësi të madhe për vetë fatet e çështjes dhe për zgjidhjen përfundimtare të saj. Kjo është dhe arsyeja se përse Kodi i Procedurës Civile mungesën e juridiksionit gjyqësor e ka konsideruar si një nga shkeljet më të rënda të normave procedurale, gjë që sjell si pasojë prishjen e vendimit nga gjykatat më të larta (neni 472, pika (b) në referencë të nenit 467).

Në nenin 59 të K.Pr.Civile parashikohet shprehimisht se: "*Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë*".

Në analizë të dispozitës së mësipërme konstatohet se çështja e juridiksionit mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor nga çdo gjykatë e pushtetit gjyqësor dhe në çdo fazë gjykimi. Çdo lloj gjykate dhe në çdo shkallë gjykimi ka të drejtë të marrë në shqyrtim, të analizojë dhe të vendosë nëse çështja është në juridiksionin gjyqësor, nëse është në juridiksionin administrativ, nëse është në juridiksionin kushtetues, nëse duhet të gjykohet nga gjykata e arbitrazhit, nëse subjekti kërkues është një subjekt i huaj i cili gëzon imunitet diplomatik, etj.

Këtë gjë gjykata mund ta bëjë *edhe kryesisht*, pra dhe pa u pretenduar nga palët dhe kjo pasi çështja e juridiksionit është e lidhur ngushtë me elementet që përbëjnë administrimin e procesit gjyqësor, si dhe me të drejtën për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të KEDNJ.

Në këto kushte, sa herë që çështja e juridiksionit bëhet objekt shqyrtimi gjyqësor, fati i procesit gjyqësor do të varet nga vendimi që merr Gjykata e Lartë në fund të shqyrtimit të kësaj çështje. Në nenin 59, pika 2 të K.Pr.Civile është parashikuar shprehimisht se: *"Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë"*.

Vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili pranon ekzistencën e juridiksionit gjyqësor gjatë shqyrtimit të një çështje, i hap rrugë shqyrtimit të çështjes, pa paragjykuar në asnjë rast themelin e saj. Në këto kushte *"Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për*

zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin" (neni 60, pika 2 i K.Pr.Civile).

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se pavarësisht se këto dispozita flasin për konfliktin midis juridiksionit administrativ dhe atë gjyqësor, i njëjti parim respektohet dhe në rastin e konfliktit që mund të ekzistojë midis juridiksionit gjyqësor dhe juridiksionit të gjykatave të arbitrazhit, nga ana e gjykatës së arbitrazhit, apo nga organet gjyqësore të zakonshme.

Domosdoshmëria e zgjidhjes së këtij konflikti nga Gjykata e Lartë vjen pasi klauzola e arbitrazhit e rënë dakord mes palëve bën që pushteti gjyqësor të mos ketë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, me përjashtim të rastit kur kjo marrëveshje është e pavlefshme.

Në rastin objekt gjykimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi kërkesë të palës së paditur, Shoqërisë "ZTE Albania" shpk, ka marrë në shqyrtim pretendimin nëse kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo duhet referuar në arbitrazh në përputhje me parashikimet e palëve në kontratë.

Ky Kolegj e gjen të mbështetur konkluzionin e kësaj gjykate se çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi klauzola e parashikuar në Nenin 44 "Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve" të amendamentit nr.2, datë 18.04.2011, që palët me vullnet të lirë i kanë bërë Kontratës nr.371 Rep., 207 Kol., datë 16.01.2008, është një klauzolë e vlefshme.

Në analizë të nenit 44 të Amendamentit nr.2, datë 18.04.2011 të Kontratës nr.371 Rep., 207 Kol. datë 16.01.2008, në të cilin parashikohet se "*….Në rast se këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen brenda dyzet e pesë ditëve pas dërgimit të njoftimit me shkrim nga njëra palë, e cila kërkon zgjidhjen, secila palë mundet që ta paraqesë mosmarrëveshje në arbitrazhin e Gjykatës së Londrës për Rregulloren Ndërkombëtare të Arbitrazhit. Vendi i arbitrazhit është Anglia*", del qartë se palët ndërgjyqëse në momentin e nënshkrimit të këtij amendamenti kanë shprehur vullnetin e tyre që në rast të mos arritjes së zgjidhjes me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve, ata do t'i drejtoheshin Arbitrazhit të Gjykatës së Londrës.

Kolegji vlerëson të theksojë se, referuar të drejtës sonë procedurale, është e rëndësishme të kuptohet qartë që shprehja e vullnetit të palëve për t'iu drejtuar procedurës së arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të thotë në të njëjtën kohë dhe heqje dorë nga procedura e zakonshme e gjykimit, e cila kjo e fundit realizohet nga organet gjyqësore nëpërmjet ngritjes së padisë. Kjo heqje dorë e palëve kontraktuese nga juridiksioni gjyqësor, dhe dëshira për t'ia nënshtruar gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin mes tyre arbitrazhit bëhet pasi ato besojnë se procedura e arbitrazhit ofron për zgjidhjen e problemeve të krijuara mes tyre një zgjidhje më të shpejtë, më efektive dhe më pak të kushtueshme.

Duke qenë se në rastin kur palët zgjedhin procedurën e arbitrazhit për të gjykuar mosmarrëveshjet e tyre, kemi në të njëjtën kohë heqje dorë nga gjykimi i mosmarrëveshjeve nga organet gjyqësore, është më se e domosdoshme që klauzola e arbitrazhit të jetë e vlefshme.

Për sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se pretendimi i palës paditëse Shoqëria "Marko Tel & Hes Kablo Albania" lidhur me zbatimin e nenit 400 e vijues të K.Pr.Civile në kushtet kur palët ndërgjyqëse janë shoqëri të themeluar dhe të regjistruara sipas legjislacionin shqiptar nuk qëndron.

Kështu, në interpretim të nenit 400 i K.Pr.Civile, në të cilin parashikon se: *"Dispozitat e këtij kreu vlejnë për procedurën e gjykimeve të arbitrazhit, kur pjesëmarrësit në proces janë me banim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë dhe kur vendi i procedurës së arbitrazhit ndodhet në territorin e saj"*, Kolegji vlerëson se procedura e

arbitrazhit dhe kriteret e vlefshmërisë së klauzolës së arbitrazhit parashikuar në Nenin 404 i K.Pr.Civile nuk janë të zbatueshme për çështjen objekt gjykimi.

Në analizë të dispozitës së mësipërme konstatojmë se dispozitat e Titullit IV "Arbitrazh" Kreu I janë të vlefshme dhe të zbatueshme vetëm nëse palët të cilët me marrëveshje kanë zgjedhur për t'ia referuar mosmarrëveshjet e lindura ose që do të lindin në të ardhmen procedurës së arbitrazhit: (i) janë më banim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë; (ii) vendi i procedurës së arbitrazhit ndodhet në territorin e saj. Këto kushte duhet të plotësohen njëkohësisht në mënyrë që çështja të gjykohet në një procedurë arbitrazhi kombëtar.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në çështjen objekt gjykimi, duke analizuar përmbajtjen e Nenit 44 të Amendamentit nr.2, datë 18.04.2011 të Kontratës nr.371 Rep., 207 Kol., datë 16.01.2008, konstaton se pavarësisht se palët janë me vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë vendi i zgjedhur për procedurën e arbitrazhit nuk ndodhet në territorin e saj, duke mos u plotësuar kështu kushti i dytë i Nenit 400 të K.Pr.Civile.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë konstaton se ndodhemi përpara një arbitrazhi ndërkombëtar duke referuar në Nenin 439 të K.Pr.Civile, në të cilin parashikohet se: *"Arbitrazhi ndërkombëtar rregullohet me ligj të veçantë"*. Në mungesë të një ligji të posaçëm mbi arbitrazhin ndërkombëtar është e domosdoshme aplikimi i së drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për të vlerësuar vlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit.

Kështu, në zbatim të nenit 2 të Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958 në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", që parashikon se: *"1. Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t'ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jo kontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi. 2. Termi "marrëveshje e shkruar" do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh. 3. Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jo operative ose e pamundur për t'u zbatuar"*, në rastin në gjykim palët kanë zgjedhur që mosmarrëveshjet e tyre të gjykohen në një procedurë arbitrazhi ndërkombëtar në Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Londrës, palët kanë përcaktuar edhe vendin e zhvillimit të arbitrazhit, që do të jetë Anglia dhe ligji i aplikueshëm ligji i Wales dhe i Anglisë, ligj ky i cili zbatohet në vendin e zhvillimit të arbitrazhit.

Gjithashtu, në Notën Shpjeguese të Sekretariatit të UNCITRAL mbi Ligjin Model të një Arbitrazhi Ndërkombëtar në nenin 3 pika b (i) përcaktohet se ndodhemi përpara një arbitrazhi ndërkombëtar nëse vendi i arbitrazhit i përcaktuar me marrëveshje midis palëve ndodhet jashtë shtetit në të cilin ata kanë qendrat e biznesit, si dhe referimi i personave të të njëjtit shtet në një arbitrazh ndërkombëtar nuk pengohet as nga Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar të Gjenevës datë 21.04.1961, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin 8687, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit"… palët e një mosmarrëveshje, pavarësisht faktit që mund të janë persona juridikë ose fizikë nga i njëjti shtet, mund ta referojnë çështjen e tyre në një arbitrazh ndërkombëtar në bazë të Konventës "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958,

pavarësisht përcaktimeve të Konventës Europiane "Mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar të Gjenevës", datë 21.04.1961.

Në analizë të sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se referimi i çështjes në një arbitrazh ndërkombëtar nuk vjen në kundërshtim me nenin 37/2 të K.Pr.Civile, për sa kohë që Konventa "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York me datë 10.06.1958, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit" përbën burim legjislativ të detyrueshëm për zbatim në Republikën e Shqipërisë, vendimi nr.1460, datë 18.02.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në Nenet 59 dhe 485 të K.Pr.Civile,

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr.1460, datë 18.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Tiranë, më 06.06.2013.